



Nr. 571/P
dt. 5.11.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

VENDIM

Nr. 571 datë 29.10. 2018

Për

Miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “Sita Partners” ,për shfrytëzimin e përroit të Sulkuqit, degë e lumit Shkumbin, Njësia Administrative Polis, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC Gurshapata 4, për qëllime hidroenergjie.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 “Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore” neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d , neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Per miratimin e kushteve të pergjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”. Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”,

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “Sita Partners” ,për shfrytëzimin e përroit të Sulkuqit, degë e lumit Shkumbin, Njësia Administrative Polis, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC Gurshapata 4, për qëllime hidroenergjie.

Kordinatat e marrjes së ujit (Sistemi koordinativ Gauss Kruger).

<i>Vepra e marrjes</i>	X 44 38 183	Y 45 57 014	Z 433 m m.n.d
<i>Prurja e llogaritur</i>	0.45 m ³ /sek		
<i>Prurja mesatare</i>	0.427 m ³ /sek		
<i>Prurja ekologjike</i>	0.05 m ³ /sek		

Koordinatat e pikës së shkarkimit :

X 44 35 720

Y 45 56 768

Z 215 m m.n.d

Prurja e shkarkimit 0.45 m³/sek.

Trupi uJOR pritës

Përroi i Kengjeras

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do të jetë 790 kw.

Për përdorimin e këtij burimi uJOR duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Të mos çenohet furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të perspektivës.
- Të zbatohet grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për cdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
- Të respektohet grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektohet rregullorja ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit UJOR Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN

Dashamir BICA KU



KRYETARI I KBU

SHKUMBIN

Maksim MALAJ

